



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Opstinska Kancelarija za Zajednice i Povratak  
Municipality Office for Communities and Returns

|                              |                                                                                         |
|------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Data/Datum/Date</b>       | 16.12.2022                                                                              |
| <b>Nr/Br/No</b>              | Nr. 02/2/_____                                                                          |
| <b>Për/Za/To</b>             | Kryetarin e Komunës, Z. Qemajl Aliu                                                     |
| <b>Përmes/Preko/Through</b>  |                                                                                         |
| <b>Nga/Od/From</b>           | Ibrahim Demiri-shef i ZKKK-së                                                           |
| <b>Lënda/Predmet/Subjekt</b> | <b>RAPORT I PUNËS SË ZKKK-së - GJASHTËMUJORI I DYTË 2022</b><br>( RAPORTI VJETOR 2022 ) |

1. Kthimi;
2. Riatdhesimi;
3. Aktivitetet për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes dhe të Strategjisë së QRK për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare.
4. Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesit
5. Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve;
6. Çështje të tjera;
7. Buxheti

- Nuk ka pasur asnjë rast për kthim gjatë vitit 2022;
- Të riatdhesuar janë gjithsej 8 persona ( 1 i komunitetit shumicë dhe 7 të komunitetit ashkali )
- Është realizuar buxheti i planifikuar-subvencione për ZKKK-në-6500€;
- Janë realizuar kërkesat individuale për përkrahje në shëndetësi, strehim dhe banim, arsim si dhe ndihma emergjente me pako ushqimore-higjenike, nga buxheti i ZKKK-së;
- Është realizuar shuma prej 2000€ për subvencionimin e aktiviteteve të OJQ-ve lokale që kanë projekte të cilat i kontribuojnë interesave të përgjithshme të komuniteteve;
- ZKKK ka bashkëpunuar me Drejtoritë e shkollave dhe ka përcjellur vijimin e nxënësve të komuniteteve. Në fillim të vitit shkollor 2021/2022 kanë qenë të regjistruar 195 nxënës të komuniteteve ashkali dhe rom.. Në Shkollën e Mesme Profesionale kanë vijuar mësimin rregullisht 27 nxënës të komuniteteve. Në SHML “ Gjumnazi “ 4 nxënës, në SHFMU “ Emin Duraku “, në Shtime 101 nxënës, në SHFMU “ Lasgush Poradeci “, në Gjyrokoc 42 nxënës kurse në Vojnovc 21 nxënës. Braktisje nuk ka pasur;
- Për nxënësit e komuniteteve është mbajtur mësimi shtesë në Qendrën për Mësimnxënie, e cila funksionon në SHFMU “ Emin Duraku “;

- Nxënësit e komuniteteve ashkali dhe rom, që vijnë shkollën e mesme, kanë përfituar bursa ( 24 bursa për vitin shkollor 2022/2023, për 10 muaj, nga 30€ në muaj ). Pagesa është duke u realizuar nga Ministria e Arsimit;
- Në bashkëpunim me IOM-in janë realizuar 4 projekte individuale ( serra dhe pajisje bujqësore ), ku përfitueset kanë qenë 4 femra të komunitetit ashkali. Vlera e përgjithshme e projekteve është 15,036€. Projektet janë realizuar në kuadër të Programit EU për Stabilizimin e Komuniteteve IV ( EU CSP IV ) ku është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes IOM-it dhe Komunës;
- Nga Organizata “ HELP “ kanë përfituar projekte 8 familje të komuniteteve (pajisje në vlerë 2000€ ). Gjithsej 16000€;
- Nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik kanë përfituar serra ( shuma për një serrë 537 € ) dy familje të komunitetit ashkali ndërsa një familje ka përfituar 10 krerë dhi;
- DKRS ka subvencionuar aktivitetet e OJQ-së “ Bashkimi Rinor për Bashkëveprim , që udhëhiqet nga të rinjtë e komunitetit ashkali dhe rom, përmes projektit të paraqitur në thirrjen publike, në shumë 1500€;
- Është hartuar lista prioritare për ndërtim dhe riparim të shtëpive, pas vizitave në terren;
- Nga takimet që ka mbajtur Kryetari i Komunës me përfaqësuesit e MFPT janë sigurua mjetet për përfundimin e 6 shtëpive që kishin filluar të ndërtohen në vitin 2019-përgjegjësi e ish MPMS-së. Janë ndarë gjithsej 10,578.74€. Mjetet financiare nga MFPT-së do t'i marrin përfituesit e shtëpive, për t'i përfunduar ato. Përfitues janë:

### **Kthimi:**

Kërkesa për për kthimin e personave të zhvendosur nuk ka pasur. Jemi duke zbatuar Rregulloren (QRK) Nr.02/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme. Është themeluar Komisioni Komunal për Kthim, me vendim të Kryetarit të Komunës, i cili bazohet në këtë rregullore, konkretisht në nenin 24 të saj.

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka përgatitur programin i cili ka të bëjë me databazën për personat e kthyer dhe kemi marrë pjesë në dy punëtori për aplikimin e kësaj databaze edhe në nivel lokal.

### **Riatdhesimi:**

**Altin Hasani** (komuniteti shqiptar), i lindur më 28.02.1998, në Shtime, me vendbanim në Shtime, është riatdhesuar nga Zvicra, me dhunë, më 29.03.2022 dhe është regjistruar në Sistemin për Menaxhimin e Rasteve ( SMR ). Pasi që nuk është rast i cënueshëm, është rekomanduar në Zyrën e Punës dhe të Punësimit, për aplikim në programet për punësim apo aftësim profesional.

**Gazmend Jakupi** ( komuniteti ashkali ) është riatdhesuar me familje ( bashkëshortja dhe 4 fëmijë ) nga Suedia, më 21.09.2022, në mënyrë të dhunshme. Është regjistruar në SMR si i riatdhesuar dhe i është rekomanduar Zyrës së Punës dhe të Punësimit për aplikim në programet për punësim apo aftësim profesional pasi që nuk është rast i cënueshëm.

**Ajet Avnija** ( komuniteti ashkali ) është riatdhesuar dhunshëm nga Franca, më 26.04.2022. I njëjti i është rekomanduar Zyrës së Punës dhe të Punësimit për aplikim në programet për punësim apo aftësim profesional pasi që nuk është rast i cënueshëm. Tani është në listën e përfituesve të projektit, pas aftësimit profesional.

Gjithsej të riatdhesuar në vitin 2022 janë 8 persona.

**Të riatdhesuarit në vitin 2021: Sherif Shahini,** me vendbanim në Muzeqinë, është riatdhesuar nga Kanada, me dhunë, më 02.09.2021 kurse në vitin 2022 ka përfituar projektin nga UNDP-ja,

përmes MPB-së, pas aftësimit profesional që ka mbaruar përmes Zyrës së Punës dhe të Punësimit ( ZPP ).

Edhe **Jeton Maliqi**, i riatdhesuar nga Gjermania në muajin korrik 2021 ka përfituar projekt si i riatdhesuar . Këta dy përfitues janë vizituar nga përfaqësuesi i MPB-së, ZPP dhe ZKKK për të konstatuar se kanë regjistruar biznese dhe për të parë nëse janë duke shfrytëzuar mjetet e përfituara sipas projektit.

**Emine Maliqi**, komuniteti ashkali, është e riatdhesuar nga Gjermania (më 25.06.2021) me tre fëmijë. Kjo familje ka pasur të siguruar qiranë për banim deri në fund të muajit qershor 2022, si rast i cënueshëm-nënë vetëushqyese, nga MPB-Departamenti për Ristdhesim, kurse pas muajit qershor 2022 është strehuar me qira përsëri dhe është obligim i komunës, sipas Rregulloren 22/ 2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, që t'i paguhet qiraja sipas kontratës me qiradhënësin. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka bërë pagesën, në shumë mujore prej 100€, për këtë familje deri në fund të këtij viti, por mbetet ende obligim i komunës që t'i paguhet qiraja, deri në zgjidhjen e problemit të strehimit për këtë familje.

Pëderisa ZKKK ka në zbatim Rregulloren 22/ 2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, janë mbajtur kontakte të rregullta me Koordinatorin Rajonal të Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Nga Kryetari i komunës është marrë vendim për formimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, konform rregullores.

#### **Aktivitetet për Integrimin e Komuniteteve RAE sipas Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Shtimes**

- Në kuadër të Projektit “Përfshirja Sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe grupe të tjera të cënueshme në Kosovë”, ka vazhduar bashkëpunimi me OJQ “ VORAE “ ku në punë praktike me pagesë ( 3 muaj ), në ZKKK, është angazhuar Adelina Balija-komuniteti ashkali.

ZKKK ka bashkëpunuar me Drejtoritë e shkollave dhe ka përcjellur vijimin e nxënësve të komuniteteve. Në fillim të vitit shkollor 2021/2022 kanë qenë të regjistruar 195 nxënës të komunitetit ashkali dhe rom.. Në Shkollën e Mesme Profesionale kanë vijuar mësimin rregullisht 27 nxënës të komuniteteve. Në SHML “ Gjimnazi “ 4 nxënës, në SHFMU “ Emin Duraku “, në Shtime 101 nxënës, në SHFMU “ Lasgush Poradeci “, në Gjyrcok 42 nxënës kurse në Vojnovc 21 nxënës. Braktisje nuk ka pasur.

Për fëmijët e komuniteteve është mbajtur mësimi shtesë në Qendrën për Mësimnxënie, e cila funksionon në SHFMU “ Emin Duraku “, në Shtime. Kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Koordinatorin e kësaj Qendre, z. Muhamet Mehmeti, dhe kemi përkrahur aktivitetet e saj.

- Nxënësit e komuniteteve ashkali dhe rom, që vijnë shkollën e mesme, kanë përfituar bursa ( 24 bursa për vitin shkollor 2022/2023, për 10 muaj, nga 30€ në muaj ). Pagesa është duke u realizuar nga Ministria e Arsimit.

#### **Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesit**

Në bashkëpunim me IOM-in janë realizuar 4 projekte individuale ku përfituese kanë qenë 4 femra:

1. Florie Brahimi-Shtime- Serrë ( 4508€ )
2. Shkurte Baftiu-Shtime-Frizere ( 3000€ )
3. Lumturie Berisha-Maliqi-Shtime- Serrë ( 3528€ )
4. Nixhare Kadria-Gjyrcovc- Pajisje për bujqësi ( 4000€ )

Projektet janë realizuar në kuadër të Programit EU për Stabilizimin e Komuniteteve IV ( EU CSP IV ).

Nga Organizata “ HELP “ kanë përfituar projekte, pajisje në vlerë 2000€ këta aplikues të komuniteteve:

1. Mehmet Sadriu-Vojnovc

2. Zenel Jakupi-Shtime
3. Gzim Hajra-Gjyrkoc
4. Hasan Qerimi-Shtime
5. Xhemajl Jakupi-Shtime
6. Behlul Kadrija-Gjyrkoc
7. Nexhat Sadria-Vojnovc
8. Safet Abazi-Vojnovc

Nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik kanë përfituar serra dy familje të komunitetit ashkali ndërsa një familje ka përfituar 10 krerë dhi:

1. Habib Tahiri-Gjyrkoc-serrë ( 537 € )
2. Gashire Haliti-Shtime-Serrë ( 537€ )
3. Safet Bajrami-Shtime-10 krerë dhi ( 1500€ )

#### **Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve - Çështje të tjera ose aktivitete:**

Të punësuar nga radhët e komuniteteve pakicë (ashkalinj dhe rom) në institucionet e Komunës së Shtimes dhe në Njësitë e Kompanive Rajonale, 2022:

| 1 | Administrata Komunale                  | M  | F | Gjithsej |
|---|----------------------------------------|----|---|----------|
|   |                                        |    | 1 | 1        |
| 2 | QKMF                                   |    | 1 | 1        |
| 3 | Shkolla                                | 3  | 1 | 4        |
| 4 | Policia e KosovësAdministrata Komunale |    | 1 | 1        |
| 5 | Shtëpia e komunitetit                  |    | 1 | 1        |
| 6 | KR “ Pastërtia “                       |    | 7 | 7        |
|   | GJITHSEJ                               | 11 | 4 | 15       |

Në koordinim me Zyrën e Kryministrit për Çështje të Komuniteteve në punë praktike, me pagesë, në Shtëpinë e Kulturës, ka qenë i angazhuar studenti Erxhan Mehmeti ( komuniteti ashkali ), për gjashtë muaj.

Në bashkëpunim me shoqatat, KFOR-in Turk dhe Bizneset si dhe donatorët e tjerë janë ndarë pako ushqimore dhe higjienike për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Pakot janë shpërndarë në bashkëpunim me liderët e komuniteteve- kryesia e PAI, të cilët edhe kanë kontribuar në përfitimin e tyre. Gjithsej pako 148. Me këtë rast donatorët kanë ndihmuar 3 famije me fëmijë jetim, nga 200€ për familje ( Listën e përfituesve posedon ZKKK-ja ). Gjithashtu janë ndihmuar me miell 13 familje të komuniteteve.

Në organizim të liderëve të komunitetit ashkali është arritur që t'i ndërtohet shtëpia Nexhmije Kadriut, në Gjyrkovc. ZKKK ka ndihmuar me shumën 479.97€ kurse komuniteti ka ndihmuar me shumën rreth 8000€.

**Në listën prioritare për ndërtim të shtëpive mbeten ende këto familje:**

- 1.Baki Jakupi-Shtime
- 2.Lulzim Rama-Gjyrkovc
- 3.Urim Shabani-Shtime, mbindërtim
- 4.Muhib Bajrami-Gjyrkovc
- 5.Jeton Maliqi-Shtime ( i riatdhesuar )
- 6.Shashivar Tahiri-Gjyrkovc
- 7.Besnik Mehmeti-Shtime ( i kthyer nga rajoni )

**Për vitin 2023 mbetet lista e njëjtë për riparim të shtëpive:**

1. Bajrush Bajrush-Shtime
2. Zejnë Bajrami-Gjyrkovc
3. Florim Abazi-Vojnovc
4. Mexhit Rama-Gjyrkovc
5. Bexhet Bajrush-Shtime
6. Shaban Ilazi-Gjyrkovc
7. Rrahim Maliqi-Shtime

Lidhur me ndërtimin e 6 shtëpive për komunitetin ashkali dhe rom, nga MFPT, që kanë mbetur ende të papërfunduara plotësisht, nga vitet paraprake, kemi marrë konfirmimin se këto familje do të ndihmohen me mjete financiare nga kjo ministri, edhe atë:

- 1.Naim Demiri-Shtime 1446.95€ ( MPMS )
- 2.Shkelzen Osmani-Shtime 1349.25€ ( MPMS )
- 3.Ramiz Kadriu-Gjyrkovc 1476.25€ ( MPMS )
- 4.Basri Maliqi-Shtime 1263.85€ ( MPMS )
- 5.Elmi Shabani-Shtime-Shtime 3603.69€ ( MPMS )
- 6.Arben Osmani-Shtime 1438.75 € ( MPMS )

Kjo është arritur pas takimeve që ka pasur edhe Kryetari i Komunës me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, konkretisht me zv. Ministrin z Resul Makreshi.

**Buxheti:**

**Nga buxheti i ZKKK-së-Subvencione janë realizuar kërkesat, si vijon:**

| Nr | Emri dhe mbiemri | Lënda      | Vendi   | Shuma  |
|----|------------------|------------|---------|--------|
| 1  | Ajriz Hasani     | Shendetesi | Gjurkoc | 152.6  |
| 2  | Bajrush Bajrush  | Renovim    | Shtime  | 440.45 |
| 3  | Baki Jakupi      | Shëndetësi | Shtime  | 102.6  |
| 4  | Elmi Shabani     | Shëndetësi | Shtime  | 100    |
| 5  | Haxh Bajrami     | Qira       | Shtime  | 300    |
| 6  | Safete Kadrija   | Shëndetësi | Gjyrkoc | 273    |
| 7  | Shaban Brahimi   | Shëndetësi | Shtime  |        |

|    |                     |                    |         |                 |
|----|---------------------|--------------------|---------|-----------------|
|    |                     |                    |         | 300             |
| 8  | Violeta Shabani     | Shëndetësi         | Shtime  | 101.3           |
| 9  | Ramiz Balija        | Per festen e Romve | Shtime  | 199.5           |
| 10 | Rexhep Velija       | Renovim            | Shtime  | 364.2           |
| 11 | Hamdi Krasniqi      | Renovim            | Shtime  | 200             |
| 12 | Samire Mehmeti      | Shëndetësi         | Shtime  | 300             |
| 13 | Nexhmije Kadrija    | Renovim            | Shtime  | 479.97          |
| 14 | OQJ Art Stars Union | Aktivitete rinore  | Shtime  | 2000            |
| 15 | Muhamet Mehmeti     | Programi Veror     | Shtime  | 490             |
| 16 | Mensur Kadrija      | Student            | Gjyrkoc | 400             |
|    | <b>Gjithsej</b>     |                    |         | <b>6203.62€</b> |

Kërkesat e refuzuara:

| Nr | Emri dhe mbiemri | Lënda           | Shuma |
|----|------------------|-----------------|-------|
| 3  | Lumnije Asllani  | Shëndetesi      |       |
| 4  | Hastret Durmishi | Karroc per pune |       |
| 6  | Rrahman Kadrija  | Shëndetsi       |       |

Për vitin 2022, komunitetet ashkali dhe rom, duke marrë parasysh kërkesat e realizuara nga ZKKK dhe donacionet nga programet e ndryshme të Organizatave dhe OJQ-ve, kanë përfituar:

Nga:

|                 |            |                                             |
|-----------------|------------|---------------------------------------------|
| ZKKK            | 6203.62€   | ( Kërkesa individuale ) ;                   |
| DKRS            | 1500€      | ( OJQ “ Bashkimi Rinor për Bashkëveprim ) ; |
| DZHE            | 2574€      | ( 2 serra+10 krerë dhi ).                   |
| MASHT+VORAE     | 7200€      | ( bursa për 24 nxënës )                     |
| IOM-i:          | 15,036€    | ( 4 projekte individuale )                  |
| Organizata HELP | 16.000€    | ( 8 projekte )                              |
| MFPT            | 10,578.74€ | ( ndihmë për përfundimin e 6 shtëpive )     |

---

**Gjithsej** **44,071.396€**

Përveç kësaj shume, nga donatorët e ndryshëm pako ushqimore kanë përfituar 148 familje, ndihma për 3 famije me fëmijë jetim, nga 200€ për familje dhe 13 familje janë ndihmuar me miell.

**Punët dhe aktivitetet e ZKKK-së janë realizuar në harmoni me:**

- Planin vjetor të punës së ZKKK-së, 2022 ;
- Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare - 2017-2021;
- Rregulloren (QRK) - Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme;
- Rregulloren 22/ 2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar;
- Planin Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Shtimes 2018-2021;
- Planin Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019 – 2022;
- Marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Komunës-Qeverisë dhe IOM-it për realizimin e Programit EU për Stabilizimin e Komuniteteve IV ( EU CSP IV .